

Bibël për fëmijët paraqet



Vajza Që Jetoi Dy Herë



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Janie Forest

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Adaptuar nga: Ruth Klassen

Tregimi 49 nga 60

www.M1914.org

Bible for Children, PO Box 3, Winnipeg, MB R3C 2G1 Canada

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.

Shqip

Albanian

Jairi ishte një drejtues fetar Jude, që adhuronte Perëndinë dhe u mësonte Fjalën e Tij të tjerëve.

Një ditë, një siklet i madh i ra Jairit.



1

Vajza e tij e dashur, vetëm dymbëdhjetë vjeçe, u sëmur. Dukej sikur askush nuk e ndihmonte dot.

Ishte një sëmundje shumë e keqe. Jairi e dinte që vajza e tij po vdiste.



2

Vetëm një njeri mund ta ndihmonte vajzën e Jairit. Jairi doli për të kërkuar Jezusin dhe ta sillte Atë në shtëpinë e tij.



Jairi mbase e dinte se miqtë e tij fetarë nuk e miratonin Jezusin.


3

Por Jairi nuk donte t'ia dinte. Ai duhej të gjente shpejt ndihmë, përpara se vajza e tij të vdiste.



4

Jairi e gjeti Jezusin të rrethuar nga njerëz. Ai u gjunjëzua tek këmbët e Jezusit.



5

"Vajza ime e vogël dergjet për vdekje", njeriu i dëshpëruar iu lut. "Eja dhe vendos duart e tua mbi të, që ajo të mund të shërohet dhe të jetojë".



6

Jezusi shkoi me Jairin. Por ata nuk lëviznin dot shpejt për shkak të turmës së madhe. Një grua kishte qenë e sëmurë për nja dymbëdhjetë vjet të mira.



7

Ajo kishte shkuar në të gjithë mjekët (dhe kishte shpenzuar gjithë paratë e saj) pa gjetur ndihmë. Oh sa dëshironte ajo të shikonte Jezusin!



8




Çfarë mund të bënte kjo grua? "Nëse vetëm do të prek rrobat e Tij, do të shërohem", mërmëriti me vete gruaja. Ajo ngadalë dhe me vështirësi iu afrua Jezusit. Pastaj duke shtrirë dorën e saj, preku rrobën e Tij.

9



NJË MREKULLI! NJË MREKULLI! Gruaja u shërua. Menjëherë! Plotësisht! Ajo e dinte se ishte shëruar dhe ishte shëndosh e mirë. Por, atëherë një zë foli. "Kush më preku"? pyeti Jezusi. Turmat e kishin prekur Atë. Por gruaja që ishte shëruar e kuptoi që duhej të tregonte ç'kish ndodhur. E ndrojtur, ajo i tregoi Atij të gjithë historinë.

10



Pikërisht atëherë shërbëtorët erdhën nga shtëpia e Jairit. Fytyrat e tyre mbase tregonin historinë e trishtueshme edhe pa fjalët e tyre. "Vajza jote ka vdekur"! i thanë ata Jairit.

11



Vdekur! Ishte tepër vonë. Mbase sikur ajo gruaja mos ti kishte vonuar gjërat ... mbase, sikur ... Vdekur! Vajzëza e shtrenjtë, e vogël, e embël e Jairit kishte shkuar.

12



Kur Jezusi e dëgjoi, ai u përgjigj, "Mos ki frikë; vetëm beso, dhe ajo do të shërohet". Sa e vështirë do të ketë qënë për Jairin ti besonte me të vërtetë Jezusit. Vajza e tij kishte vdekur.

13



Në shtëpi, të gjithë po qanin dhe vajtonin për vajzën. "Ajo nuk ka vdekur, por po fle" u tha Jezusi atyre. Ata e përqeshën. Ata e dinin që vajza kishte vdekur.

14

Jezusi i nxorri jashtë të gjithë ata, mori vajzën nga dora dhe tha, "Vajzë e vogël, çohu". Jairi ishte atje. Gruaja e tij ishte atje.



15

Tre nga dishepujt e Jezusit ishin atje. Ata të gjithë i dëgjuan fjalët e Jezusit. A do ti dëgjonte edhe vajza e vogël?



16

Vajza e vdekur e dëgjoi urdhërin e Jezusit. Fryma u kthye në të dhe ajo u çua menjëherë. Jezusi e kishte ringjallur atë prej së vdekurish.



17

Prindërit e vajzës u mrekulluan. Jezusi u tha atyre që ti jepnin vajzës diçka për të ngrënë. Sa të lumtur ishin ata! Sa mirënjohës ndaj Jezusit! Dashuria dhe fuqia e Tij e mrekullueshme kishte ringjallur vajzën e tyre prej së vdekurish.



18

Vajza Që Jetoj Dy Herë

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Markut 5, Llukës 8

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Denimi për mëkatin është vdekja.

Perëndia na don neve aq shume sa që dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdes në Kryq dhe të paguaj dënimin tonë. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lartë në Qiell.

Nëse ti do që të pendohesh, thuaja këtë Perëndisë: Perëndi i dashur, unë besoj në Jezusin që vdiq për mua dhe jeton. Të lutem eja në jetën time dhe m'i fal mëkatet, në mënyrë që të kem jetën e re. Dhe që të jem me Ty përgjithmon. Më ndihmo që të jetoj për Ty si fëmija i Yt. Amen. Gjoni 3:16

Lexo Biblën dhe fol me Perëndinë çdo ditë!

